



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1259 Prot.

Tiranë, më 18/08/2025

VENDIM

Nr. 36, DATË 18/08/2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MARRJEN E KANDIDATURAVE PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT TË PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pika 1, germa "i", nenin 46 të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në nenin 30, pika 3, germa "a" dhe nenin 31 të Statutit të Universitetit të Arteve; në nenin 21, pika 2, germa "a" dhe nenin 22 të Rregullores së Universitetit të Arteve; në nenin 4, pikat 1, germa "t" dhe "s" të Rregullores së Funksionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës për marrjen e kandidaturave për anëtarë të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Arteve.
2. Komisioni përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:
 - a. Të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
 - b. Të mbajnë titullin "Profesor" dhe të kenë së paku pesë vite përvojë në mësimdhënie pas fitimit të këtij titulli.
4. Aplikimet duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/P-A, duke dorëzuar kërkesën për vetëkandidim sipas formatit bashkëngjitur këtij vendimi dhe afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data 28 / 08 /2025.
5. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald Bakalli

Prof. Najada Hamza

Prof. Arben Llozi

Prof. Miltiadh Kutali

Prof. Sadik Spahija

Prof. Lorenc Radovani

Prof. Vladimir Myrtezaj (Grosha)

Prof. Endri Sina

Prof. Rudina Ciko

Prof. Gazmend Gjoka

Prof. Asoc. Dorian Çene

Prof. Asoc. Albes Fusha

Prof. Asoc. Edmond Gjikapulli

Prof. Asoc. Kristina Laço

Prof. Asoc. Genci Fuga

Prof. Asoc. Alert Çeloaliaj

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea Trimi (Student FAB)

Rei Kita (Student FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2025

**KËRKESË PËR VETËKANDIDIM
PËR
ANËTAR NË KOMISIONIN E PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK**

Unë i/e nënshkruar/i/a _____ (Emër, Atësi, Mbiemër), lindur më ____/____/_____, në _____, anëtar/e i/e personelit akademik pranë Fakultetit të _____, paraqes kërkesën time për të vetëkandiduar për anëtar në Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik të Universitetit të Arteve.

Në përputhje me rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik (KPPA) të Universitetit të Arteve”, miratuar me VSA nr. 18, datë 11.04.2024, si dhe duke qenë në dijeni se deklaratimet e rreme nga ana ime në këtë kërkesë, përveç përgjegjësisë penale, sjellin automatikisht heqjen e të drejtës për kandidim për këtë pozicion, nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se:

- jam anëtar i personelit akademik me kohë të plotë në Universitetin e Arteve;
- mbaj titullin “Profesor”;
- kam përvojë në mësimdhënie, më shumë se 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit “Profesor”.

(Emër, Mbiemër, Firmë)

